




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

ODBOR ZA POLITIKU I FINANSIJE

COMMISSION FOR POLITICS AND FINANCE

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal

22.08.2025

Takimi i mbajtur me datën 22.08.2025 në hapësirat e Komunës së Mitrovicës Veriore me fillim në ora 10:00.

Në takim janë të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Nedzad Ugljanin
2. Flutura Hamza - Azemi
3. Aida Ferati - Doli
4. Gzim Alushi
5. Dusan Milunovic

Të pranishëm të tjerë mediat lokale, dhe përfaqësues të misionëve ndërkombëtare.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Nedzad Ugljanin, ku si fillim përshëndeti të pranishmit

Rendi i ditës sipas rregullores së kuvendit

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Vendimi për mbrojtjen e simboleve Shtetërore
- 3.Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës, nga toka Bujqësore në tokë

Ndërtimore

- 4.Raportimi i zbatimit të planit të integritetit komunal

- 5. Kërkesat e qytetarëve
- 6. Të ndryshme

Rendi i ditës votohet me 5 vota "Për".

Kryesuesi: Pika e parë është miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar.

Procesverbali votohet me 5 vota "Për".

Kryesuesi: Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, vendimit për mbrojtjen e simboleve shtetërore, ato i mbron Kushtetuta e Republikës së Kosovës, mirëpo ne duhet të merremi me mbrojtjen e simboleve komunale. Çdo dokument protokollohet me simbole komunale. Kam pasur konsultime me MAPL-në, por megjithatë ne do të marrim vendim për mbrojtjen e simboleve komunale. Unë do të konsultohem sërish me MAPL-në, sepse simbolet shtetërore do të jenë jashtë ndërtesës së komunës, në korridor dhe në ndërtesë, në Kuvend. Në kuadër të Kuvendit duhet të jetë simboli komunal. Të martën do të konsultohem me zyrën ligjore të MAPL-së, gjithashtu do të kërkoj nga ekzekutivi që simbolet e komunës të jenë edhe në Kuvend, si dhe për sa i përket përdorimit të gjuhës sipas statutit të komunës.

Dushani: Nuk e kuptova, propozimi i kujt ishte kjo pikë? A ka pasur ndonjë shkelje të simboleve shtetërore? A ka pasur ndonjë problem apo shqetësim?

Kryesuesi: Jo Dushan, ka të bëjë me një gabim teknik, sepse nuk bëhet fjalë për simbole shtetërore, por për ato komunale, sepse në asnjë statut nuk thuhet që duhet të mbrohen simbolet komunale.

Dushani: Çdo qeverisje mund të kërkojë simbolet e veta, prandaj nuk mund të thuhet se nuk bëjnë të ndryshohen.

Kryesuesi: Për këtë arsye po them se ka qenë një gabim; nuk kemi të bëjmë me simbole shtetërore, por komunale, prandaj kam pasur konsultime me MAPL-në. Unë nuk e kam gjetur askund në statut sepse po ta gjeja, do ta merrja vendimin në bazë të statutit. Gjithashtu nuk e kam gjetur në asnjë udhëzim administrativ. Pas konsultave me zyrën ligjore të MAPL-së kam kërkuar nëse gjenden në ligj, atëherë të veprojmë sipas ligjit. Ne nuk do të marrim vendime pa bazë ligjore, sepse deri tash kemi vepruar duke u bazuar në ligj. Është obligim ligjor që këto simbole të gjenden në Kuvend.

Kryesuesi: Kalojmë te pika e tretë të rendit të ditës. Ky propozim-vendim vjen nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Gjeodezi. Propozimin e keni pranë vetes. Ju, Dushan, e dini më mirë se ku ndodhet ky lokacion në Kodrën e Minatorëve, tek poligoni.

Dushani: Po, tek fusha e lojërave, pra është tek këndi i lojërave të fëmijëve, sipas skicës gjithmonë.

Kryesuesi: Dua të theksoj se në momentin kur janë shpallur zgjedhjet nga kryetarja, pas konsultimeve kam kuptuar se mund të votojmë. Sikur të ishte tokë komunale apo hapësirë publike, nuk do të kishim të drejtë ta votojmë.

Dushani: Nuk kuptoj, a është pronë komunale apo bëhet vetëm ridestininim?

Kryesuesi: Këtu thuhet që do të shfrytëzohet për ndërtimin e një shkolle, dhe me siguri për shkollë do të përdoret. Mirëpo edhe komunat tjera kanë bërë ankesa për disa ridestinime. Ne nuk jemi ankuar si komunë, sepse nuk kanë gjetur askund ku thuhet se nuk kanë të drejtë të marrin vendime të tilla.

Dushani: Ju vetë na keni treguar shkresën ku thuhet se pas shpalljes së zgjedhjeve nuk lejohet marrja e vendimeve. Si ka mundur të vijë ky propozim-vendim nga ekzekutivi? Më mirë të dërgojnë një shkresë në MAPL duke pyetur si të veprojnë tutje.

Kryesuesi: Zyra ligjore e MAPL-së mandej mund ta kthejë si jo ligjore.

Dushani: Ne i kemi kthyer disa qytetarë me kërkesë për këtë arsye, prandaj tani do t'u kthejmë edhe kërkesat e tyre. Mendoj se një shqiptar ka qenë ai që ka kërkuar leje për vend parkimi, të cilën kërkesë e kemi refuzuar.

Kryesuesi: Kemi pasur dy kërkesa të cilat nuk i kemi shqyrtuar, por nëse ky propozim-vendim kalon sërish, MAPL do të vendosë.

Dushani: A mund të kërkoj unë plotësim të rendit të ditës, si qytetarët që mund të bëjnë kërkesa të tilla, e pastaj të vendos MAPL? Unë këtë mund ta kërkoj edhe në Kuvend.

Kryesuesi: Ju mund ta bëni, por për legalizim individual nuk mund të marrim vendime. Do të thotë se për këtë duhet të bëhet ekspertiza dhe të vlerësohet nga Zyra për Kadaster, dmth sërish Drejtoria vendos për këto propozime. Edhe pse ka pasur kohë të mjaftueshme për qytetarët sa i përket legalizimit, edhe qeverisja e ardhshme do të merret me këtë problem. Ata e kanë cekur në kërkesë se aty do të ndërtohet një shkollë fillore.

Dushani: Ne kemi qenë në atë shkollë dhe kemi parë kushtet në të cilat mbahet mësimi. Është një kontenier ku mbahet mësimi. E di që edhe ndihmat që kemi dashur t'ua japim nuk na kanë lejuar, duke thënë se i takon Komunës së Mitrovicës Jugore.

Kryesuesi: Ka ekzistuar një marrëveshje mes dy kryetarëve të komunave, mirëpo edhe pse i patëm ndarë mjetet, nuk janë lejuar. Nuk e dimë si ka ardhur deri tek kjo.

Dushani: Kjo ka qenë menjëherë pas luftës; ndoshta ka qenë e nevojshme të gjendet një mënyrë si të veprohet.

Kryesuesi: Prandaj ende nuk janë ndarë ato afër 2000.00 € nga subvencionet vetanake të Kuvendit Komunal, dhe unë mendoj që kjo është kundërligjore. Ne kemi të drejtë në subvencionet tona, dhe pasi në shtator do të aprovohet buxheti, do të kërkoj që të rritet buxheti ynë, sepse në këtë buxhet duhet t'i dalim në ndihmë mjeksore qytetarëve, si dhe për sport, kulturë etj.

Kryesuesi: Tani vijmë tek pika e katërt, raportimi i zbatimit të planit të integritetit. Po e shoh tani, sepse nuk e kam parë më parë.

Gezimi: Kjo është propozuar tani?

Dushani: Kush e ka sjellë, ministria?

Kryesuesi: Zyrtarja përgjegjëse për raportim e ka përcjellë tek Zyra për Punë të Kuvendit, të njëjtin e kanë përcjellë përmes emailit tek anëtarët e Kuvendit, me qëllim që t'i informojnë me kohë.

Dushani: Ne jemi rast specifik, jemi e vetmja komunë që këtë e bëri në fund të mandatit.

Kryesuesi: Duhet përkthyer në gjuhën serbe ky dokument. Po e shoh që është nënshkruar nga kryetari i komunës. Kalojmë tek kërkesat e qytetarëve, kërkesë nga Jelena Ilić sa i përket OJQ “Shapa”, lexohet kërkesa e OJQ-së.

Gezimi: Çka është në pyetje, kryesues?

Kryesuesi: Lexon kërkesën e OJQ-së.

Dushani: Dy-tre herë kemi votuar. Më mirë të bisedojmë me drejtoreshën para seancës dhe të pyesim në çfarë mënyre të bëhet pagesa. Nëse nuk mund t'i ndihmojmë OJQ-së në fjalë, atëherë ti ndihmojmë ndonjë qytetari, pasi ka kërkesa të shumta.

Kryesuesi: Për shembull, ata nuk kanë të drejtë të përzihen për mjetet që i ka ndarë Kuvendi, sepse ne vendosim a do të ndahen mjetet tona për ndonjë OJQ apo tjetër. Ne kemi votuar disa kërkesa, sepse mjetet janë tona dhe ata nuk kanë të drejtë të përzihen.

Kryesuesi: Nuk kam parë asnjë shkresë as nga ministria, as nga thesari që nuk kemi të drejtë, as verbale, as me shkrim. Kemi një peticion për lirim të parkingut.

Dushani: Do të thotë të gjithë fqinjët e kryetarit të komunës?

Kryesuesi: Lexon peticionin për lirim të parkingut, po ashtu edhe kërkesat e qytetarëve.

Dushani: Ekziston Drejtoria për Shëndetësi, por ne jemi të gatshëm t'u ndihmojmë pasi janë drejtuar neve.

Kryesuesi: Nëse nuk keni diçka më shumë për të shtuar, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe shihemi në takim të ardhshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

Procesmbajtës:

Bujar ISUFI



Kryesuesi i Komisionit për Politikë dhe Financa:

Nedžad UGLIANIN

